



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.22

2004

16 prill

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9203 datë 15.3.2004	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për projektin “Programi i mbrojtjes së mjedisit të liqenit të Ohrit - masa shoqëruese””	1153
Ligj nr.9204 datë 15.3.2004	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Bullgarisë për transportin detar tregtar”	1155
Ligj nr.9205 datë 15.3.2004	Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë	1160
Ligj nr.9207 datë 15.3.2004	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.....	1171
Vendim i Kuvendit nr.125, datë 18.3.2004	Për miratimin e raportit vjetor të Këshillit Kombëtar të Radios dhe të Televizionit (KKRT)	1173
Vendim i Kuvendit nr.126, datë 23.3.2004	Për shkarkimin nga detyra të anëtarit dhe kryetarit të Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.....	1174
Vendim i Kuvendit nr.127, datë 23.3.2004	Për caktimin e kryetarit dhe zgjedhjen e një anëtarit të Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve	1174

Vendim i Kuvendit nr.128, datë 23.3.2004	Për dhënien e pëlqimit për emërimin e një gjyqtari të Gjykatës së Lartë	1175
Vendim i KM nr.179, datë 10.4.2004	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të mjediseve të degës së mobilizimit në qytetin e Çorovodës, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”	1175
Vendim i KM nr.180, datë 10.4.2004	Për dhënien e emrit “Spiro Moisiu” Akademisë së Mbrojtjes	1176
Vendim i KM nr.184, datë 10.4.2004	Për masën e indeksimit të pagave për vitin 2004.....	1176
Udhëzim i MF nr.2, datë 17. 2.2004	Për disa ndryshime në udhëzimin nr.15, datë 16.7.2003 "Për procedurat e hapjes dhe të mbylljes së sallave të lojërave aritmetike, elektronike dhe pikave të lojërave të fatit sportiv"	1177
Udhëzim i MF nr.3, datë 3.3.2004	Për procedurat e titullimit të përkohshëm të auditëve të brendshëm publikë	1177
Urdhër i MF nr.2591, datë 30.3.2004	Për kualifikimin dhe certifikimin e auditëve të brendshëm publikë.....	1180
Vendim i GJK nr.7, datë 1.4.2004	Me objekt ndreqje të gabimit material në vendimin nr.20, datë 2.7.2003 të Gjykatës Kushtetuese, si dhe ripërtëritjen e aktit	1181

L I G J
Nr.9203, datë 15.3.2004

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR PROJEKTIN “PROGRAMI I MBROJTJES SË MJEDISIT TË LIQENIT TË OHRIT - MASA SHOQËRUESE””

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për projektin “Programi i mbrojtjes së mjedisit të liqenit të Ohrit - masa shoqëruese””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4189, datë 5.4.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË
PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR (VITI 2000)

“PROGRAMI I MBROJTJES SË MJEDISIT TË LIQENIT TË OHRIT - MASA SHOQËRUESE”

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë:
në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;
duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë;
të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj Marrëveshjeje;
me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;
duke iu referuar bisedimeve ndërqeveritare të datës 23 qershor 2000,
u morën vesh si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë u jep mundësi Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe marrësve të tjerë, që do të zgjidhen bashkërisht nga të dyja Qeveritë, të marrin nga Kreditanstalt für Wiederaufbau, Frankfurt mbi Majn, një shumë financimi prej gjithsej 766 937,82

euro (me fjalë shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e tridhjetë e shtatë 82/100 euro), për projektin “Programi i mbrojtjes së mjedisit të liqenit të Ohrit - masa shoqëruese”, kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t’u mbështetur.

2. Po të merren vesh Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet me projekte të tjera.

3. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Qeverisë së Republikës të Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau shuma të tjera financimi për masa të mëtejshme shoqëruese për projektin e përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatim kjo Marrëveshje.

Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në neni 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratën që do të përfundohet ndërmjet Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe marrësit të shumës së financimit, e cila u nënshtrohet dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 paragrafi 1 do të zhvlefësohet, në rast se kontrata përkatëse e financimit nuk përfundohet brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premimit. Për shumën në fjalë ky afat mbaron me datën 31 dhjetor 2008.

2. Qeveria e Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ajo vetë nuk është marrëse e shumës së financimit, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau për pretendimet eventuale lidhur me shlyerjen e shumës, të cilat mund të ngrihen në bazë të kontratës së financimit që do të përfundohet sipas paragrafit 1.

Neni 3

Qeveria e Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratës së përmendur në nenin 2.

Neni 4

Qeveria e Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore që rezultojnë nga dhënia e shumës së financimit, nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën kur Qeveria e Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë më ----- në dy origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe atë gjermane, duke pasur të dy tekstet fuqi të barabartë.

L I G J
Nr.9204, datë 15.3.2004

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË BULLGARISË PËR TRANSPORTIN DETAR TREGTAR”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Bullgarisë për transportin detar tregtar”, nënshkruar në Sofje më 13 qershor 2003.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4190, datë 5.4.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE DYPALËSHE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË BULLGARISË PËR TRANSPORTIN DETAR TREGTAR

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Bullgarisë, më poshtë të quajtura “Palë Kontraktuese”;

duke njohur rëndësinë e zhvillimit të transportit detar tregtar ndërmjet të dy vendeve; bazuar në principet e barazisë dhe të interesit reciprok;

duke dëshiruar të forcojnë bashkëpunimin në fushën e transportit detar tregtar, mbi bazën e principeve të lirisë së transporteve,

ranë dakord si më poshtë:

Neni 1

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

1. Me shprehjen “Anije e Palës Kontraktuese” kuptohet çdo anije, e regjistruar në përputhje me legjislacionin e Palëve Kontraktuese dhe që mbajnë flamurin e shtetit, si dhe çdo anije që merret me qira. “Anije me qira” do të kuptojmë çdo anije, regjistruar në një vend të tretë në përputhje me legjislacionin e tij, që lundron me flamurin e atij shteti dhe operohet nga një person fizik ose juridik të një prej Palëve Kontraktuese, në përputhje me legjislacionin e tyre. Ky term nuk përfshin anijet luftarake dhe anijet e tjera që përdoren për qëllime jotregtare, si: hidrografike, kërkime shkencore dhe anijet e peshkimit.

2. Me shprehjen “Anëtar i ekuipazhit” do të kuptohet kapiteni dhe çdo person tjetër, i përfshirë në listën e ekuipazhit të anijes, që ndodhet në atë moment në bord dhe që ushtron funksione që kanë të bëjnë me drejtimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin gjatë lundrimit.

3. Autoritetet kompetente janë:

- Për Republikën e Shqipërisë, Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit,
- Për Republikën e Bullgarisë, Ministria e Transportit dhe e Komunikacioneve.

Neni 2

Marrëveshja aktuale zbatohet në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në territorin e Republikës së Bullgarisë.

Neni 3

Bashkëpunimi ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Bullgarisë në fushën e transportit detar tregtar do të bazohet në principet e barazisë, njohjes së pavarësisë kombëtare dhe interesit reciprok.

Palët Kontraktuese do t’i ofrojnë njëra-tjetrës asistencën e nevojshme për zbatimin e parimit të lirisë në transportin detar tregtar dhe nuk do t’i referohen marrjes së masave të cilat bllokojnë lundrimin detar.

Neni 4

Palët Kontraktuese do të nxisin bashkëpunimin ndërmjet ndërmarrjeve, organizatave dhe autoriteteve, të cilat operojnë në fushën e transportit detar në vendet e tyre.

Neni 5

1. Palët Kontraktuese ranë dakord:

a) Të nxisin përfshirjen e anijeve të Palëve Kontraktuese në furnizimin e shërbimeve të transportit detar ndërmjet porteve të vendeve të tyre.

b) Të bashkëpunojnë në eliminimin e pengesave, të cilat mund të dëmtojnë zhvillimin e transportit ndërmjet porteve të vendeve të tyre.

c) Të abstenuhen nga vonesa e anijeve të njëres nga Palët Kontraktuese për të siguruar shërbimin e transportit detar ndërmjet porteve të Palës tjetër Kontraktuese për të siguruar shërbimin e transportit detar ndërmjet porteve të Palës tjetër Kontraktuese dhe porteve të vendeve të treta.

2. Klauzolat e paragrafit 1 të këtij neni nuk do të cenojnë të drejtën e anijeve të vendeve të treta që të marrin pjesë në shërbimet e transportit detar ndërmjet porteve të Palëve Kontraktuese.

Neni 6

1. Secila nga Palët Kontraktuese do t’u rezervojë anijeve të Palës tjetër Kontraktuese, të njëjtin trajtim që u rezervojnë anijeve të tyre në lidhje me: hyrjen e lirë në porte, kushtet e kalatave, pajisjet e ngarkim-shkarkimit, imbarkimin dhe disimbarkimin e pasagjerëve, vënien e taksave portuale dhe shërbimet e kryera, kur ato lidhen me anije detare tregtare.

2. Klauzolat e paragrafit 1 të këtij neni nuk:

a) do të zbatohen në portet e mbyllura për anijet e huaja;

b) do të zbatohen për aktivitetet e rezervuara nga secila Palë Kontraktuese për ndërmarrjet dhe organizatat e veta, si: kabotazhi, operacionet e shpëtimit dhe të rimorkimit;

c) do të zbatohen në përjashtimin nga rregullat për pilotimin e detyrueshëm;

d) do të shkelen për zbatimin e rregullave, në lidhje me lejimin, qëndrimin dhe largimin e të huajve të Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 7

Palët Kontraktuese do të marrin të gjitha masat e nevojshme, brenda kuadrit të legjislacionit të tyre kombëtar, për të lehtësuar dhe për të nxitur transportin detar, për të evituar vonesën e anijeve në port, si dhe për të lehtësuar dhe për të shpejtuar sa më shpejt të jetë e mundur, bërjen e formaliteteve doganore dhe të formaliteteve të tjera që zbatohen në portet e tyre.

Neni 8

1. Secila nga Palët Kontraktuese do të njohë dokumentet, certifikatën e kombësisë së anijes, certifikatën e tonazhit dhe të gjitha dokumentet e tjera zyrtare të anijes, lëshuar ose njohur nga Pala tjetër Kontraktuese.

2. Anijet e secilës Palë Kontraktuese që kanë Certifikatën Ndërkombëtare të Tonazhit do të përjashtohen nga çdo matje në portet e Palës tjetër Kontraktuese. Kjo certifikatë do të përdoret si bazë për llogaritjen e taksave portuale.

Neni 9

Secila nga Palët Kontraktuese do t'i njohë dokumentet e identitetit të detarëve, të lëshuara nga autoritetet respektive të Palës tjetër Kontraktuese.

Këto dokumente të identitetit do të jenë:

- Për Republikën e Shqipërisë, pasaporta e detarit
- Për Republikën e Bullgarisë, pasaporta e detarit

Ky dokument do t'i garantojë mbajtësit kthimin në vendin që ka lëshuar atë.

Neni 10

Anëtarët e ekuipazhit të anijes të secilës Palë Kontraktuese, që mbajnë dokumentet e identitetit sipas nenit 9 të kësaj Marrëveshjeje, lëshuar nga njëra Palë, mund të lejohen gjatë qëndrimit të anijes në portin e Palës tjetër Kontraktuese, të zbresin në tokë dhe të dalin në qytetin e portit ku ndodhen, pa viza, kur kapiteni i anijes ka njohur organet lokale kompetente me listën e ekuipazhit.

Këta persona do të jenë subjekt i procedurës së kontrollit kur imbarkohen dhe disimbarkohen nga anija.

Neni 11

1. Secila Palë Kontraktuese do t'i njohë referimet e nenit 9 në lidhje me dokumentet e identifikimit, lëshuar nga Pala tjetër Kontraktuese, kur mbajtësit e këtij dokumenti kanë nevojë të qëndrojnë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese ose të kalojnë nëpërmjet territorit të saj, për t'u kthyer në bordin e anijes së tyre, për t'u kthyer në vendin e tyre ose për ndonjë qëllim tjetër, të pranuar nga kjo Palë Kontraktuese pavarësisht nga mjeti i transportit i përdorur, me kusht që këta persona të zbatojnë ligjet dhe rregullat e së njëjtës Palë Kontraktuese.

2. Secila Palë Kontraktuese do të lejojë anëtarët e ekuipazhit të anijes së Palës tjetër Kontraktuese që të qëndrojnë në spitalet në territorin e saj për periudhën e kohës që kërkohet për trajtimin mjekësor.

Secila Palë Kontraktuese, në përputhje me legjislacionin kombëtar, do të sigurojë ndihmën e nevojshme mjekësore për anëtarët e ekuipazhit të Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 12

Parashikimet e neneve 9, 10 dhe 11 do të zbatohen për çdo person i cili nuk është shtetas i secilës Palë Kontraktuese, por zotëron dokument identifikimi, në përputhje me parashikimet e Konventën e lehtësimit të trafikut ndërkombëtar detar, 1965 dhe bashkëngjitur për më tepër Konventës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) Nr.108 të dokumenteve të identifikimit të detarit. Dokumente të tilla identifikimi do të lëshohen nga vendi, anëtar i konventës respektive, dhe do të garantojë mbajtësin e saj të drejtën e kthimit në vendin e lëshimit.

Neni 13

1. Parashikimet e neneve 9-11 të kësaj Marrëveshjeje janë pa pasoja për rregullat kombëtare dhe rregulloret për hyrjen dhe daljen e të huajve nga dhe për në territorin e secilës Palë Kontraktuese.

2. Palët Kontraktuese rezervojnë të drejtën për të mos lejuar hyrjen dhe qëndrimin në territorin e tyre të personave që konsiderohen të padëshirueshëm.

Neni 14

Për qëllime të sigurisë, kapitenit të anijes të secilës Palë Kontraktuese i lind e drejta që, për të vazhduar lundrimin, të marrë detarë nga Pala tjetër Kontraktuese. Punësimi do të jetë vullnetar dhe në përputhje me legjislacionin e shtetit, flamurin e të cilit mban anija.

Neni 15

1. Në qoftë se një anije e njërës nga Palët Kontraktuese përplaset, mbytet, bie në cekëtinë ose pëson ndonjë avari, ose ndonjë incident tjetër në ujërat territoriale ose brigjet e Palës tjetër Kontraktuese, autoritetet kompetente të kësaj Pale do të garantojnë një ndihmë dhe bashkëpunim për mbrojtjen e pasagjerëve, ekuipazhit, vetë anijes dhe ngarkesës së njëjtë me atë që i garantohet anijeve që lundrojnë me flamurin e saj.

2. Në qoftë se një anije e njërës Palë Kontraktuese pëson një dëm në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, ngarkesa e saj, pajisjet dhe prona të tjera do të përjashtohen nga TVSH-ja, taksat dhe tarifat, përveç në rastin kur ato janë destinuar për konsum të drejtpërdrejtë dhe përdorim në territorin e kësaj Pale Kontraktuese.

3. Parashikimet e paragrafit 2 të këtij neni nuk do të bien në kundërshtim me ligjet, rregullat e kohës së magazinimit të mallrave, në territorin e Palës Kontraktuese.

Neni 16

Ndërmarrjet e transportit dhe organizatat e secilës Palë Kontraktuese kanë të drejtë të ngrejnë zyra agjencie në territorin e Palës tjetër Kontraktuese. Aktiviteti i këtyre zyrave do të jetë në përputhje me ligjet e vendit në territorin e të cilit ato janë ngritur.

Neni 17

1. Secila nga Palët Kontraktuese do t'u garantojë ndërmarrjeve detare dhe organizatave të Palës tjetër Kontraktuese të drejtën të përdorë të ardhurat dhe çfarëdo tjetër të realizuar në territoret e tyre nga aktivitetet e zhvilluara në zbatim të kësaj Marrëveshjeje për të mbuluar shpenzimet që do të kryhen në atë vend.

Secila nga Palët Kontraktuese do t'u garantojë ndërmarrjeve dhe organizatave detare të Palës tjetër Kontraktuese të drejtën për të transferuar të gjitha të ardhurat e mbetura pas kryerjes së pagesave të mësipërme. Ndërmarrjet dhe organizatat detare do të veprojnë kështu në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi.

2. Të gjitha pagesat që rezultojnë nga aktivitetet e rregulluara nga kjo Marrëveshje do të bëhen me çdo monedhë të huaj të konvertueshme në përputhje me interesat e organizatave të të dyja Palëve Kontraktuese.

Neni 18

1. Autoritetet kompetente të secilës Palë Kontraktuese nuk do të përfshihen në konfliktet civile ndërmjet pronarit të anijes, kapitenit dhe anëtarëve të tjerë të ekuipazhit, në lidhje me marrëdhëniet dhe kushtet e punës në bordin e anijes të Palës tjetër Kontraktuese.

2. Secila Palë Kontraktuese mund të ushtrojë procedurë gjyqësore për çdo krim, të ndodhur në bordin e anijes të Palës tjetër Kontraktuese, kur një anije e tillë qëndron në portet ose ujërat territoriale të saj.

3. Asnjë Palë Kontraktuese nuk mund të ushtrojë procedurë gjyqësore për çdo krim, të ndodhur në bordin e anijes të Palës tjetër Kontraktuese, kur një anije e tillë kalon transit në ujërat e saj territoriale, me përjashtim të rasteve të mëposhtme:

a) Në qoftë se krimi prish qetësinë e shtetit ose rregullin e vendosur në ujërat e saj territoriale.

b) Si pasojë e krimit cenohen interesat shtetërorë ose të qytetarëve të saj.

c) Për parandalimin e tregtisë ilegale të lëndëve narkotike, të substancave të rrezikshme dhe radioaktive.

d) Në qoftë se miratimi është dhënë nga kompetencat diplomatike ose konsulli i shtetit, flamurin e të cilit mban anija.

e) Në qoftë se krimi është në kundërshtim me paqen dhe njerëzimin.

4. Parashikimet e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni nuk cenojnë të drejtën e autoriteteve të secilës Palë Kontraktuese për të kontrolluar dhe investiguar ngjarjet në përputhje me legjislacionin e tyre.

Neni 19

Kur është e nevojshme, përfaqësues të organeve kompetente të Palëve Kontraktuese, do të takohen respektivisht në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Bullgarisë për të diskutuar çështje në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje ose çështje të tjera me interes të përbashkët në lidhje me transportin detar.

Neni 20

Çdo kundërshtim në lidhje me interpretimin dhe ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje do të vendoset nëpërmjet negociatave direkte ndërmjet autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese. Në qoftë se Marrëveshja nuk arrihet gjatë negociatave, konflikti do të zgjidhet në rrugë diplomatike.

Neni 21

Marrëveshja do të vendoset për një kohë të pacaktuar dhe do të hyjë në fuqi pas 30 ditësh pas datës së marrjes së njoftimit të dytë me anë të të cilit Palët Kontraktuese do të informojnë njëra-tjetrën se të gjitha kërkesat e legjislacionit kombëtar, të aplikueshme në vendet e tyre respektive, janë marrë parasysh.

Kur kjo Marrëveshje të hyjë në fuqi, vlefshmëria e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore të Bullgarisë dhe Qeverisë së Republikës Socialiste të Shqipërisë "Për transportin detar tregtar" firmosur më 19 maj 1990 në Tiranë automatikisht do të ndërpritet.

Secila Palë Kontraktuese mund ta denoncojë këtë Marrëveshje në çdo kohë me anë të njoftimit me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Denoncimi do të ketë efekt 6 muaj pas datës së marrjes së njoftimit nga Pala tjetër Kontraktuese.

Bërë në Varma, më 12. 6. 2003, në tri kopje origjinale, në gjuhët shqip, bullgarisht dhe anglisht. Të tre tekstet janë të njëjtë. Në rast të divergjencave në interpretim, teksti në anglisht është i pranueshëm.

L I G J
Nr.9205, datë 15.3.2004

PËR MBROJTJEN E DËSHMITARËVE DHE TË BASHKËPUNËTORËVE TË DREJTËSISË

Në mbështetje të neneve 78 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj rregullon masat e posaçme, mënyrën dhe procedurat e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, si dhe organizimin, funksionimin, kompetencat dhe marrëdhëniet ndërmjet organeve të ngarkuara me propozimin, vlerësimin, miratimin dhe zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Dëshmitar i drejtësisë” është personi, ndaj të cilit zbatohen masat e posaçme të mbrojtjes, i cili, në cilësinë e dëshmitarit ose të personit të dëmtuar, bën njoftime ose dëshmon për fakte e rrethana, që përbëjnë objekt prove në një procedim penal, për vepra penale të parashikuara në pikën 7 të këtij neni dhe që, për shkak të këtyre njoftimeve ose dëshmive, ndodhet në gjendje rreziku aktual, konkret dhe serioz.

2. “Bashkëpunëtor i drejtësisë” është personi, që vuan dënimin penal ose është i pandehur në një procedim penal, ndaj të cilit zbatohen masa të posaçme të mbrojtjes, për shkak të bashkëpunimit, njoftimeve dhe deklarimeve të bëra në procedime penale, për vepra penale të parashikuara në pikën 7 të këtij neni dhe që, për këto arsye, ndodhet në gjendje rreziku aktual, konkret dhe serioz.

3. “Persona të afërm” janë personat, që ndodhen në gjendje rreziku aktual, konkret dhe serioz për shkak të lidhjeve familjare, të gjinisë a krushqisë me dëshmitarin ose bashkëpunëtorin e drejtësisë, sipas përcaktimeve të nenit 16 të Kodit të Procedurës Penale dhe që, si rregull, banojnë ose bashkëjetojnë në mënyrë të qëndrueshme me ta.

4. “Persona të lidhur” janë ata persona që, për shkak të natyrës së marrëdhënieve konkrete që kanë me dëshmitarin ose bashkëpunëtorin e drejtësisë, ndodhen në gjendje rreziku aktual, konkret dhe serioz.

5. “Persona të mbrojtur” janë, bashkërisht ose veçmas, dëshmitarët, bashkëpunëtorët e drejtësisë dhe personat e afërm të tyre ose personat e tjerë të lidhur me ta, sipas përcaktimeve të bëra në pikat 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni.

6. “Gjendje rreziku” është gjendja aktuale, konkrete dhe serioze, për shkak të së cilës personit të mbrojtur i rrezikohet jeta, shëndeti, të drejtat dhe liritë themelore, të parashikuara nga ligji, si dhe prona e të drejtat e lidhura me të.

7. “Krim i rëndë”, në zbatim të këtij ligji, janë veprat penale të parashikuara në nenet 73, 74, 75, 79, 89 shkronja “a”, 100, 101, 109, 110 shkronja “a”, 111, 114 shkronjat “a” e “b”, 128 shkronja “b”, 208, 209, 211, 213, 219, 220, 221, 222, 230, 230 shkronja “a”, 231, 232, 233, 234, 278 shkronja “a”, 282 shkronja “a”, 283, 284 shkronjat “a”, “c” e “ç”, 286, 287, 333 dhe 334 të Kodit Penal, si dhe dispozitat e tjera penale, që shprehimisht përfshihen në zbatimin e dispozitave të këtij ligji.

KREU II

ORGANET PËRGJEGJËSE PËR MBROJTJEN E DËSHMITARËVE DHE BASHKËPUNËTORËVE TË DREJTËSISË

Neni 3

Organet përgjegjëse

Organe përgjegjëse për përgatitjen, vlerësimin, miratimin dhe zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes së dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë janë:

- a) Drejtoria e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë;
- b) Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

Neni 4

Drejtoria e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë

1. Për përgatitjen, ndjekjen dhe zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes, ngrihet Drejtoria e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, si strukturë e posaçme qendrore e Policisë së Shtetit, në varësi të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, e cila e shtrin veprimtarinë e vet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Struktura dhe organika e Drejtorisë së Mbrojtjes të Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë miratohen nga Ministri i Rendit Publik.

3. Çështjet që lidhen me trajtimin e punonjësve të Drejtorisë së Mbrojtjes të Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Rregullat për administrimin e posaçëm të pasurive dhe fondeve të nevojshme për ushtrimin e veprimtarive të Drejtorisë së Mbrojtjes të Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë caktohen me udhëzime të përbashkëta të Ministrit të Rendit Publik, të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Drejtësisë.

Neni 5

Fusha e veprimtarisë së Drejtorisë së Mbrojtjes të Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë

1. Drejtoria e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë ka këto kompetenca:

a) përgatit për shqyrtim në Komisionin e Vlerësimit të Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë propozimet e dërguara nga Prokurori i Përgjithshëm, për marrjen e masave të posaçme të mbrojtjes;

b) me kërkesë të Prokurorit të Përgjithshëm ose të Komisionit të Vlerësimit të Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, pasi bën verifikimet e nevojshme, paraqet informacione shtesë për aspektet teknike të propozimit, për zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes;

c) vendos zbatimin e masave të përkohshme të mbrojtjes deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, në rastet dhe mënyrën e parashikuar sipas këtij ligji;

ç) përgatit dhe nënshkruan marrëveshjen për masat e posaçme të mbrojtjes me persona të mbrojtur sipas këtij ligji;

d) ndjek zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes, të miratuara nga Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë;

dh) administron bazën e të dhënave, që lidhet me veprimtarinë e Drejtorisë së Mbrojtjes të Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë dhe ecurinë e masave të posaçme të mbrojtjes dhe merr masa për t'i siguruar dhe administruar ato, në përputhje me shkallën e nevojshme të klasifikimit të informacionit, sipas dispozitave në fuqi;

e) administron pasuritë dhe fondet në dispozicion të Drejtorisë të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë për ushtrimin e veprimtarisë së vet dhe zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes;

ë) propozon dhe merr masa për bashkërendimin e punëve me institucione të tjera për zhvillimin e veprimtarive dhe zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë;

f) ndjek çështjet e bashkëpunimit me struktura ndërkombëtare ose të shteteve të tjera për fushën e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë;

g) përgatit raporte periodike për veprimtarinë e vet dhe bën propozime për përmirësimin e legjislacionit dhe të veprimtarisë së institucioneve, për zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë.

2. Drejtoria e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, pasi merr miratimin, në parim, të Komisionit të Vlerësimit të Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, përgatit rregullat me karakter teknik dhe operativ për kushtet, metodikat dhe procedurat e verifikimit, të përgatitjes dhe zbatimit të masave të zakonshme dhe të posaçme të mbrojtjes, për mënyrat, format dhe mjetet e komunikimit, si dhe për administrimin e akteve dhe të informacionit që lidhet me veprimtarinë e vet.

Neni 6

Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë

1. Për vlerësimin e propozimeve, miratimin e masave të posaçme të mbrojtjes, ndryshimin, revokimin ose përfundimin e tyre ngrihet Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

2. Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë kryesohet nga Zëvendësministri i Rendit Publik dhe ka këtë përbërje:

- | | |
|------------------------------------|------------------|
| a) një gjyqtar | zëvendëskryetar; |
| b) një prokuror | anëtar; |
| c) një oficer i policisë gjyqësore | anëtar. |

3. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit caktojnë, përkatësisht, një nga anëtarët për përbërjen e këtij komisioni. Thirrja e tyre, për të marrë pjesë në mbledhjet e Komisionit të Vlerësimit të Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, bëhet nga Kryetari i Komisionit.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit caktojnë, përkatësisht, edhe nga një kandidat tjetër alternativ, të cilët marrin pjesë në mbledhjet e Komisionit për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë në rastet kur respektivisht mungojnë anëtarët e këtij Komisioni, të caktuar sipas paragrafit të mësipërm të këtij neni.

4. Gjyqtarët, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, që caktohen anëtarë të Komisionit për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, duhet të kenë besueshmëri dhe figurë të pastër morale, përvojë e njohuri të veçanta profesionale në fushën penale dhe sidomos për krimin e rëndë dhe atë të organizuar.

5. Anëtarët e Komisionit për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë caktohen në detyrë për një afat trevjeçar me të drejtë riemërimi. Anëtarësia në këtë Komision përfundon përpara këtij afati në këto raste:

a) kur anëtari nuk e ushtron më funksionin në institucionin nga i cili ose për shkak të të cilit është emëruar si anëtar i Komisionit për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë;

b) me kërkesën e vet, të shoqëruar me arsyeime të bazuara;

c) për shkelje të dispozitave të këtij ligji dhe të rregullave të funksionimit të Komisionit për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

6. Vendimi për përfundimin e qëndrimit në detyrë të anëtarit të Komisionit për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, në rastin e shkronjës “a” të pikës 5 të këtij neni merret dhe njoftohet nga organi kompetent për emërimin e tyre, ndërsa në rastet e shkronjave “b” dhe “c”, përkatësisht, me kërkesë të vetë anëtarit ose të vetë këtij Komisioni.

7. Gjyqtarët, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore anëtarë të Komisionit për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, nuk mund të marrin pjesë në diskutim dhe në vendimmarrje, kur vihen në dijeni që propozimi për masa të posaçme mbrojtjeje ka lidhje me procedime penale apo veprimtari që hetohen ose gjykohen prej tyre. Ky ndalim vlen edhe kur ka konflikt interesash ose dyshime për njëanshmëri të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale dhe në dispozitat e tjera ligjore në fuqi.

8. Rregullat e hollësishme për kriteret dhe procedurat për thirrjen dhe pjesëmarrjen në mbledhjen e Komisionit për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, për ngarkesën e punës, mungesën, pengesën dhe pamundësinë e caktimit dhe të kryerjes së kësaj detyre caktohen me udhëzime të përbashkëta të Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrit të Rendit Publik dhe të Ministrit të Drejtësisë.

Neni 7

Mbledhjet e Komisionit për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë

1. Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë thirret në mbledhje nga Kryetari dhe, në mungesë të tij, nga Zëvendëskryetari, brenda 5 ditëve nga paraqitja e propozimit të Prokurorit të Përgjithshëm për zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes. Në raste të veçanta dhe urgjente ky Komision mblidhet menjëherë.

2. Mbledhjet e Komisionit për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë janë të vlefshme kur janë të pranishëm tre anëtarë të tij. Vendimet e tij janë të vlefshme kur miratohen nga tre anëtarë të pranishëm në mbledhje.

3. Komisioni merr vendim jo më vonë se 10 ditë nga mbledhja e parë dhe, në çdo rast, jo më vonë se 30 ditë nga depozitimi i dokumentacionit përkatës dhe i propozimit të Prokurorit të Përgjithshëm.

4. Aktet dhe çdo informacion për veprimtarinë e Komisionit për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë konsiderohen informacion i klasifikuar.

5. Rregullat e hollësishme për funksionimin dhe procedurat e punës së Komisionit për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, si dhe për të drejtat, detyrimet dhe trajtimin e anëtarëve të tij caktohen me udhëzime të përbashkëta të Prokurorit të Përgjithshëm, të Ministrit të Rendit Publik, të Ministrit të Drejtësisë dhe të Ministrit të Financave.

KREU III

MASAT E POSAÇME PËR MBROJTJEN E DËSHMITARËVE DHE BASHKËPUNËTORËVE TË DREJTËSISË

Neni 8

Kushtet e përgjithshme për zbatimin e masave të posaçme për mbrojtjen e dëshmitarëve të drejtësisë

1. Kur zbatimi i masave të zakonshme të mbrojtjes për dëshmitarin e drejtësisë nuk është i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm, zbatohen masa të posaçme të mbrojtjes, sipas këtij ligji, nëse ai pranon dhe bashkëpunon me vullnet të lirë me organin e prokurorisë dhe gjykatën dhe nëpërmjet dëshmisë së vet të plotë, të bërë pa kushte dhe rezerva, jep të dhëna të bazuara që:

- a) përbëjnë prova vendimtare për një procedim penal për krime të rënda;
- b) ndihmojnë në parandalimin e kryerjes së krimeve të rënda ose në zvogëlimin e pasojave që shkaktohen prej tyre;
- c) ndihmojnë për riparimin e dëmeve dhe të humbjeve të shkaktuara nga kryerja e krimeve të rënda.

2. Zbatimi i masave të posaçme të mbrojtjes për dëshmitarin e drejtësisë vendoset vetëm nëse ai ndodhet në gjendje rreziku aktual, konkret dhe serioz, është i përshtatshëm për t'u përfshirë në këto masa dhe me kusht që me vullnetin e vet të lirë pranon dhe merr pjesë aktivisht në zbatimin e tyre.

3. Në varësi të rrethanave konkrete, masat e posaçme të mbrojtjes mund të vendosen nga Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë edhe për personat e afërm ose të lidhur me dëshmitarin e drejtësisë.

4. Rregullat dhe kriteret e hollësishme, për çështjet e parashikuara në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, caktohen me udhëzime të përbashkëta të Prokurorit të Përgjithshëm, të Ministrit të Rendit Publik dhe të Ministrit të Drejtësisë.

Neni 9

Kushtet e përgjithshme për zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes për bashkëpunëtorët e drejtësisë

1. Kur zbatimi i masave të zakonshme të mbrojtjes për bashkëpunëtorin e drejtësisë nuk është i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm zbatohen masa të posaçme të mbrojtjes dhe të trajtimit, sipas këtij ligji, nëse personi pranon dhe bashkëpunon me organin e prokurorisë dhe gjykatën dhe kur nëpërmjet të dhënave dhe deklarimeve realisht të bazuara:

- a) bën të ditura, gjatë procedimit penal, fakte dhe rrethana, që shërbejnë si prova vendimtare dhe të pazëvendësueshme për zbulimin, hetimin dhe gjykimin e krimeve të rënda;
- b) ndihmon ose dëshmon për parandalimin e krimeve të rënda dhe riparimin e dëmeve a të humbjeve të shkaktuara nga kryerja e tyre.

2. Zbatimi i masave të posaçme të mbrojtjes vendoset vetëm nëse bashkëpunëtori i drejtësisë ndodhet në gjendje rreziku aktual, konkret dhe serioz, është i përshtatshëm për t'u përfshirë në këto masa dhe me kusht që ai, gjatë gjithë procesit, të bëjë deklarime të plota, pa kushte e rezerva, të pranojë zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes dhe, me vullnetin e vet të lirë, të marrë pjesë aktivisht në zbatimin e tyre.

3. Në varësi të rrethanave konkrete, masat e posaçme të mbrojtjes vendosen nga Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë edhe për personat e afërm ose të lidhur me bashkëpunëtorin e drejtësisë.

4. Rregullat dhe kriteret e hollësishme për çështjet e parashikuara në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni caktohen me udhëzime të përbashkëta të Prokurorit të Përgjithshëm, të Ministrit të Rendit Publik dhe të Ministrit të Drejtësisë.

Neni 10

Masat e posaçme të mbrojtjes

1. Masat e posaçme të mbrojtjes për dëshmitarët, bashkëpunëtorët e drejtësisë dhe personat e afërm ose të lidhur me ta janë:

a) ndryshimi i identitetit;

b) ndryshimi i vendbanimit;

c) mbrojtja e përkohshme e identitetit, e të dhënave dhe dokumenteve të personit të mbrojtur;

ç) dhënia e deklarimeve të dëshmitarit nën një identitet tjetër dhe administrimi i tyre me mjete të veçanta për deformimin e zërit, të pamjes së vërtetë të tij dhe forma të tjera të caktuara sipas ligjit;

d) masa të veçanta mbrojtëse, fizike dhe teknike, në vendin ku qëndron personi i mbrojtur, si dhe gjatë lëvizjeve të tij, përfshirë edhe ato për përmbushjen e detyrimeve ndaj organeve të drejtësisë;

dh) mbrojtja dhe trajtimi i posaçëm, në rastet kur, për kryerjen e një vepre penale, bashkëpunëtorit të drejtësisë i është caktuar masë sigurimi ose është dënuar me burgim;

e) rehabilitimi social;

ë) ruajtja, ndryshimi dhe sigurimi i përkohshëm i vendit të punës;

f) dhënia e ndihmës financiare në kohën ndërmjet dy punësimeve;

g) rikualifikimi profesional;

gj) dhënia e këshillave dhe e ndihmës së specializuar ligjore;

h) mënyra të tjera të caktuara sipas ligjit.

2. Masat e posaçme të mbrojtjes nuk zbatohen në masën dhe mënyrën, që sjell si pasojë përmirësimin e gjendjes ekonomike të personit të mbrojtur, vetëm për shkak të zbatimit të tyre.

3. Masat e posaçme të mbrojtjes, si rregull, vendosen për një afat të pacaktuar dhe mund të shtrihen në të gjitha fazat e procedimit penal, si dhe pas përfundimit të tyre.

4. Kohëzgjatja e zbatimit të masave të posaçme të mbrojtjes varet nga ekzistenca dhe niveli i gjendjes së rrezikut, përshtatshmëria e personit të mbrojtur në raport me masën e posaçme të mbrojtjes që zbatohet, si dhe nga korrektësia e tij në përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe kushteve të parashikuara në marrëveshjen e mbrojtjes.

5. Rregullat dhe kriteret e hollësishme për përmbajtjen, kuptimin, përshtatshmërinë, mënyrën dhe procedurat e caktimit dhe të shkallëzimit të zbatimit të masave të posaçme të mbrojtjes caktohen me udhëzime të përbashkëta të Prokurorit të Përgjithshëm, të Ministrit të Rendit Publik dhe të Ministrit të Drejtësisë.

Neni 11

Përgjegjësia për zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes

1. Drejtoria e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë përgjigjet për përgatitjen, bashkërendimin e punëve dhe ndjekjen e zbatimit të masave të posaçme të mbrojtjes.

2. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, sipas përgjegjësisë dhe detyrave të ngarkuara nga ligji, organizojnë punën dhe përgjigjen për ndjekjen dhe zbatimin e masave të zakonshme dhe të posaçme të mbrojtjes së personave të mbrojtur.

3. Organet e përmendura në pikën 2 të këtij neni bashkërendojnë punën e tyre me Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, i përgjigjen kërkesave të kësaj Drejtorie dhe atyre të prokurorit, si dhe njoftojnë për çështje e rrethana që kanë të bëjnë me përgatitjen e propozimeve, zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes dhe të marrëveshjeve përkatëse, të lidhura për këtë qëllim me persona të mbrojtur.

4. Rregullat e hollësishme për detyrat, përgjegjësitë, format dhe procedurat e bashkërendimit e të informimit, ndërmjet institucioneve, caktohen me udhëzime të përbashkëta të Ministrit të Rendit Publik, të Ministrit të Drejtësisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm.

Neni 12

Administrimi i akteve, i dokumentacionit dhe i informacionit

1. Aktet, dokumentacioni dhe çdo informacion që lidhet me propozimin, miratimin dhe zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes konsiderohen informacion i klasifikuar dhe mbahen e administrohen nga Drejtoria e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

2. Kriteret dhe procedurat për ruajtjen, administrimin dhe klasifikimin e informacionit për masat e posaçme për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë caktohen me udhëzime të përbashkëta të Ministrit të Rendit Publik, të Ministrit të Drejtësisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm.

3. Aktet, dokumentacioni, të dhënat, si dhe çdo informacion që zotërojnë dhe administrojnë ministritë dhe institucionet e tjera qendrore për masat e posaçme të mbrojtjes konsiderohen informacion i klasifikuar. Titullarët e institucioneve miratojnë udhëzimet përkatëse për depozitimin, mbajtjen dhe administrimin e tyre, pasi të kenë marrë mendimin e Ministrit të Rendit Publik, të Ministrit të Drejtësisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm.

KREU IV

PROCEDURAT PËR MIRATIMIN DHE ZBATIMIN E MASAVE TË POSAÇME TË MBROJTJES

Neni 13

Paraqitja e propozimit

1. Të drejtën për të propozuar zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes e ka Prokurori i Përgjithshëm.

2. Prokurori i Përgjithshëm i propozon Komisionit të Vlerësimit të Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë shqyrtimin dhe miratimin e masave të posaçme të mbrojtjes, në rastet kur gjykon dhe ka motive, që e justifikojnë zbatimin e këtyre masave.

3. Propozimi për miratimin e masave të posaçme të mbrojtjes, së bashku me informacionin bazë, sipas këtij ligji, depozitohen pranë Drejtorisë së Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, e cila kryen edhe funksionet e sekretarisë teknike. Kjo Drejtori bën përgatitjen e materialit që do të shqyrtohet nga Komisioni i Vlerësimit të Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

4. Prokurori i Përgjithshëm, kur është rasti, së bashku me propozimin dhe duke parashtruar arsyet, mund t'i kërkojë Drejtorisë së Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë që, në përputhje me rrethanat konkrete, të zbatojë masa të përkohshme e të përshtatshme të mbrojtjes.

5. Rregullat dhe procedurat e parashikuara në këtë nen zbatohen edhe në rastet e propozimit për ndryshimin ose heqjen e masave të posaçme të mbrojtjes.

Neni 14

Masa të përkohshme të mbrojtjes

1. Në raste të veçanta dhe urgjente, Drejtoria e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, me kërkesën e prokurorit dhe pasi të ketë marrë miratimin me shkrim të personit të mbrojtur, vendos zbatimin e menjëhershëm të masave të përkohshme të mbrojtjes. Vendimi i Drejtësisë bëhet i zbatueshëm, pasi të jetë miratuar nga Kryetari i Komisionit të Vlerësimit të Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë dhe Prokurori i Përgjithshëm ose një prokuror i autorizuar posaçërisht prej tij.

2. Masat e përkohshme të mbrojtjes vendosen në përputhje me shkallën e gjendjes së rrezikut, në forma të tilla që garantojnë përkohësisht dhe paraprakisht nivelin minimal të domosdoshëm të mbrojtjes.

3. Rregullat e hollësishme për rastet, procedurat dhe mënyrat e mbrojtjes së përkohshme, caktohen me udhëzime të përbashkët të Ministrit të Rendit Publik, të Ministrit të Drejtësisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm.

Neni 15

Përmbajtja e propozimit për zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes dhe dokumentacioni shoqërues

1. Propozimi i Prokurorit të Përgjithshëm për zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes përmban domosdoshmërisht të dhënat e mëposhtme:

- a) të dhëna personale të personit, që propozohet të mbrohet;
- b) informacion për ecurinë e çështjes penale dhe vlerësimin e provave të mbledhura;
- c) shpjegime për rëndësinë e deklarimeve të bëra apo që mund të sigurohen nga dëshmitari ose bashkëpunëtori i drejtësisë, si dhe për shkaqet përse dhënia e lirë e dëshmimeve a deklarimeve nuk mund të sigurohet në mënyrë tjetër;
- ç) rrethanat në të cilat ose për shkak të të cilave dëshmitari ose bashkëpunëtori i drejtësisë ka marrë dijeni për të dhënat dhe deklaratimet që ka bërë ose që mund të sigurohen prej tij;
- d) të dhëna dhe shpjegime të tjera që shërbejnë për të motivuar dhe mbështetur vlerësimin për gjendjen e rrezikut, ku ndodhet apo parashikohet të ndodhet personi që propozohet të mbrohet;
- dh) informacione për gjendjen financiare të dëshmitarit;
- e) informacione të tjera sipas vlerësimit të prokurorit.

2. Prokurori i Përgjithshëm mund t'i kërkojë Drejtësisë së Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë përpunimin dhe përgatitjen e informacioneve më të hollësishme ose shtesë për motivet dhe efektet e zbatimit të masave të posaçme të mbrojtjes.

Neni 16

Marrëveshja me personin e mbrojtur

1. Në një kohë sa më të shkurtër dhe në çdo rast jo më vonë se 15 ditë nga miratimi i masave të posaçme të mbrojtjes, Drejtoria e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë përgatit marrëveshjen për zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes dhe merr masa për bisedimin dhe nënshkrimin e saj me dëshmitarin, bashkëpunëtorin e drejtësisë dhe persona të tjerë të mbrojtur.

2. Në rastet që çmohet prej tij, prokurori merr pjesë në përgatitjen dhe bisedimin e kushteve të marrëveshjes së posaçme për zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes.

3. Në çdo rast, prokurori vihet në dijeni dhe jep pëlqimin e tij përpara se marrëveshja të nënshkruhet nga Drejtoria e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë dhe personi i mbrojtur.

4. Përgjegjësitë, të drejtat, detyrimet dhe efektet e masave të posaçme të mbrojtjes për Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë dhe personin e mbrojtur fillojnë në kohën dhe mënyrën e parashikuar në marrëveshje.

5. Në rastin kur personi i mbrojtur është i mitur, duke respektuar në çdo rast parimet e interesit më të lartë të tij dhe ato të zotësisë për të vepruar, të parashikuara në dispozitat përkatëse ligjore, dhënia e pëlqimit dhe nënshkrimi i marrëveshjes së mbrojtjes bëhen nga prindi ose kujdestari i tyre, i caktuar sipas ligjit.

6. Në rastin kur personi i mbrojtur është madhor, të cilit, për shkak sëmundjeje psikike ose zhvillimi të metë mendor, i është hequr tërësisht ose pjesërisht zotësia për të vepruar, dhënia e pëlqimit dhe nënshkrimi i marrëveshjes së mbrojtjes bëhen nga kujdestari i tyre, i caktuar sipas ligjit.

Neni 17

Përmbajtja e marrëveshjes

1. Në marrëveshjen e mbrojtjes parashikohen detyrimisht këto çështje:

a) të drejtat dhe detyrimet e personave të mbrojtur;
b) të drejtat dhe detyrimet e Drejtorisë së Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë për të ofruar mbrojtjen e duhur, sipas nivelit dhe rrethanave të rrezikut për personin e mbrojtur;

c) rastet dhe rrethanat e ndryshimit dhe të heqjes së masave të posaçme të mbrojtjes;

ç) kohëzgjatja e parashikuar, paraprakisht, për zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes.

2. Marrëveshja e mbrojtjes parashikon, gjithashtu, rregullimin më të hollësishëm të përmbushjes nga dëshmitari ose bashkëpunëtori i drejtësisë të kushteve dhe detyrimeve si më poshtë:

a) të japë informacion të plotë dhe pa asnjë rezervë a kusht për të gjitha faktet, ngjarjet dhe rrethanat, që lidhen me veprën penale dhe për të cilat ai ka dijeni;

b) të pranojë dhe të respektojë kushtet e përmendura në masat e posaçme të mbrojtjes;

c) të mbajë parasysh natyrën e informacionit të klasifikuar dhe, në çfarëdo rrethane, të mos bëjë të ditur asnjë të dhënë për masat e posaçme të mbrojtjes dhe të dhëna të tjera të lidhura me to;

ç) të mënjanojë çdo veprim ose mosveprim, që mund të rrezikojë zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes ose që mund të sjellin si pasojë një gjendje tjetër rreziku për personin e mbrojtur;

d) të informojë menjëherë Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë për çështje që çmohen dhe kërkohen prej saj, ose për ngjarje apo ndryshime të rrethanave të jetës ose veprimtarive të tij personale, si dhe për kontaktet e marrëdhëniet me të tretë, që mund të rrezikojnë zbatimin dhe garancitë e ofruara nga masat e posaçme të mbrojtjes;

dh) të pranojë pa nevojën e një vendimi gjyqësor të posaçëm që, nëse është e domosdoshme për qëllimet e mbrojtjes, të përdoren në mjediset e veta mjete teknike të ruajtjes, vëzhgimit, përgjimit dhe regjistrimit.

3. Përveç sa parashikohet në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, dëshmitari ose bashkëpunëtori i drejtësisë detyrohet të informojë Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë me hollësi për llojet dhe masën e pasurive të zotëruara prej tij ose personave të afërm apo të lidhur posaçërisht me ta.

4. Drejtoria e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë informon Komisionin e Vlerësimit të Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë në kohën dhe mënyrën e caktuar prej tij, për ecurinë, afatet e zbatimit të programit të mbrojtjes, respektimin e kushteve të marrëveshjes së mbrojtjes, si dhe, rast pas rasti, për probleme dhe rrethana të paparashikuara në këto dokumente.

5. Rregullat e hollësishme për procedurat e shprehjes së vullnetit, bisedimit dhe nënshkrimit, për formën dhe përmbajtjen, si dhe për ndjekjen e zbatimit të kushteve të marrëveshjes së mbrojtjes caktohen me udhëzime të përbashkëta të Ministrit të Rendit Publik, të Ministrit të Drejtësisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm.

Neni 18

Masa mbrojtjeje të jashtëzakonshme

1. Policia e Shtetit, institucionet ku mbahen të paraburgosurit ose ata që vuajnë dënime penale, sipas shkallës së gjendjes së rrezikut për personin e mbrojtur, mund të urdhërojnë dhe zbatojnë masa mbrojtjeje të jashtëzakonshme, ndërmjet atyre të parashikuara në këtë ligj apo me dispozita të tjera, që rregullojnë veprimtarinë e tyre. Këto masa, jo më vonë se 24 orë nga marrja e tyre, i njoftohen Drejtorisë së Mbrojtjes të Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë dhe prokurorit të çështjes.

2. Masat e jashtëzakonshme, me pëlqimin e Drejtorisë së Mbrojtjes të Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë dhe të prokurorit të çështjes, mund të zgjaten derisa të mënjanohet rreziku që ka motivuar marrjen e tyre ose deri në marrjen e vendimit përkatës nga Komisioni i Vlerësimit të Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

Neni 19

Ndryshimi dhe heqja e masave të posaçme të mbrojtjes

Masa e posaçme e mbrojtjes mund të ndryshojë ose të hiqet në këto raste:

a) nëse vlerësohet se nuk ekziston më gjendja e rrezikut, që motivon zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes;

b) nëse gjatë hetimit dhe gjykimit të çështjes penale, vërtetohet se dëshmitari ose bashkëpunëtori i drejtësisë bën dëshmi ose jep informacione të rreme;

c) nëse personi i mbrojtur kryen një vepër penale me dashje;

ç) nëse pas fillimit të zbatimit të masave të posaçme të mbrojtjes sigurohen të dhëna të arsyeshme dhe të bazuara për përfshirjen e personit të mbrojtur në veprimtari kriminale;

d) nëse dëshmitari, bashkëpunëtori i drejtësisë ose persona të tjerë të mbrojtur nuk respektojnë detyrimet e përmendura në marrëveshjen e mbrojtjes ose refuzojnë, neglizhojnë apo japin informacion të rremë;

dh) nëse personi i mbrojtur refuzon mundësinë e punësimit të siguruar nga Drejtoria e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë ose heq dorë nga kryerja e veprimtarive, që sigurojnë të ardhura pa asnjë motiv të bazuar;

e) nëse një autoritet i një shteti tjetër kërkon mbarimin e masës së posaçme të mbrojtjes, të ndryshimit të vendbanimit, të zbatuar në territorin e atij shteti.

Neni 20

Raste të përfundimit të masave të posaçme të mbrojtjes

Masa e posaçme e mbrojtjes përfundon në rastet e mëposhtme:

a) me mbarimin e afatit të marrëveshjes së mbrojtjes;

b) nëse ka vdekur personi i mbrojtur;

c) me kërkesë me shkrim të personit të mbrojtur ose kujdestarit të tij;

ç) për shkak të heqjes dorë nga zbatimi i masave të posaçme të mbrojtjes dhe marrëveshja e saj.

Neni 21

Njoftime për ndryshimin, heqjen ose përfundimin e masave të posaçme të mbrojtjes

1. Drejtoria e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë njofton menjëherë, me shkrim, prokurorin për rrethanat e përmendura në nenet 19 dhe 20 të këtij ligji.

2. Në rastin e kërkesës për përfundimin e masave të posaçme të mbrojtjes ose kur ka vdekur personi i mbrojtur, masa e posaçme e mbrojtjes hiqet menjëherë për kërkesin ose për personin e vdekur, por ajo mund të vazhdojë sipas vlerësimit të rrethanave, për personat e tjerë të mbrojtur, të përfshirë në ato masa të posaçme të mbrojtjes.

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 22 **Bashkëpunimi ndërkombëtar**

1. Bashkëpunimi ndërkombëtar realizohet në përputhje me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare ku është palë Republika e Shqipërisë.

2. Marrëveshjet ndërkombëtare mund të parashikojnë zbatimin e ndërsjellë të masave të posaçme të mbrojtjes, përfshirë ndryshimin e vendbanimit dhe qëndrimin e personave të mbrojtur në territoret përkatëse të palëve.

Neni 23 **Aktet nënligjore**

1. Këshilli i Ministrave, ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore, brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore të caktuara, sipas këtij ligji, të marrin masat për ngritjen e Drejtorisë për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë dhe të Komisionit për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, jo më vonë se 60 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 24 **Efektet e ligjit**

Mbrojtja e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, sipas këtij ligji, fillon në ditën e parë pas përfundimit të afatit 6-mujor, të parashikuar në nenin 23 të tij.

Neni 25 **Dispozitë kalimtare**

1. Deri në datën e caktuar sipas nenit 24 të këtij ligji, në raste të jashtëzakonshme dhe për aq sa është e mundur të respektohen kriteret dhe procedurat e këtij ligji, Prokurori i Përgjithshëm dhe Ministri i Rendit Publik, pasi të kenë marrë mendimin e Ministrisë të Drejtësisë, mund të vendosin dhe të zbatojnë një a më shumë masa të posaçme të mbrojtjes.

2. Për vazhdimësinë, ndryshimin ose revokimin e masave të posaçme të mbrojtjes, të zbatuara, sipas pikës 1 të këtij neni, Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë jep vendimin e vet jo më vonë se 30 ditë nga data e ngritjes së tij.

Neni 26 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4191, datë 5.4.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

L I G J
Nr.9207, datë 15.3.2004

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7870, DATË 13.10.1994 “PËR
SIGURIMET SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në pikën 2 të nenit 4, pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“c) të gjitha shërbimet e ekzaminimeve unike, terciare dhe konsultat mjekësore të miratuara nga Këshilli i Ministrave.”.

Neni 2

Neni 11 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 11

1. Kontributet në fondin e sigurimeve shëndetësore paguhen çdo muaj. Afati i pagimit të kontributeve është jo më vonë se data 25 e muajit pasardhës. Punëdhënësi është i detyruar të mbajë nga paga kontributin për të punësuarin dhe ta derdhë atë së bashku me kontributin e vet në organet tatimore ose në llogaritë e Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ose Instituti i Sigurimeve Shoqërore, sipas rastit, është përgjegjës për transferimin e kontributeve në Institutin e Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor.

2. Personat e vetëpunësuar paguajnë kontributet për veten dhe për punonjësit e papaguar të familjes dhe i derdhin në organin përkatës, sipas afateve të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave.

3. Personi i detyruar për pagesën e kontributeve të sigurimeve shëndetësore dorëzon në organin përkatës përmbledhjen e kontributeve dhe deklaratën përkatëse të pagesës, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në pikat 1 e 2 të këtij neni.”.

Neni 3

Pikat 1 dhe 2 të nenit 12 ndryshohen si më poshtë:

“1. Të gjithë personat e detyruar për të paguar kontribute për efekt të sigurimeve shëndetësore, regjistrohen në organet tatimore ose në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, sipas rastit. Regjistrimi i të punësuarve bëhet nga punëdhënësi i tyre. Personi që ka detyrimin për të paguar kontributet pajis çdo punëmarrës ose punonjës të papaguar të familjes me numrin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe regjistron shumat e paguara për secilin gjatë periudhës në marrëdhënie pune, qofshin këto në të holla apo përfitime në natyrë.

2. Nëse pagimi i kontributeve nga personat e detyruar nuk bëhet brenda afatit, mbahen interesat për pagesë të vonuar. Masa e interesit është ajo e përcaktuar në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” me ndryshimet përkatëse.”.

Neni 4

Në pikën 1 të nenit 12/1 fjala “të punësuarve” zëvendësohet me fjalën “të siguruarve”.

Neni 5

Nenet 12/1 e 12/2 bëhen përkatësisht 12/2 e 12/3, si dhe shtohet neni 12/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 12/1

Kur nuk përbëjnë vepër penale, shkeljet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë:

a) për mosregjistrimin e veprimtarisë ekonomike në organet përgjegjëse për mbledhjen e kontributeve punëdhënësi gjobitet me 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, ndërsa i vetëpunësuarit me 20 000 (njëzet mijë) lekë;

b) çdo person tjetër, që detyrohet të paguajë kontributet, por që nuk regjistrohet në organin përkatës gjobitet me 20 000 (njëzet mijë) lekë;

c) punëdhënësi, që dorëzon me vonesë deklaratën e kërkuar sipas këtij ligji, gjobitet me 10 për qind të shumës së kontributit të deklaruar me vonesë, por jo më pak se 10 000 (dhjetë mijë) lekë;

ç) çdo person tjetër i detyruar të paguajë kontributet, që dorëzon me vonesë deklaratën e kërkuar, sipas këtij ligji, gjobitet me 10 000 (dhjetë mijë) lekë;

d) punëdhënësi, që deklaron kontribute më të ulëta gjobitet me 50 për qind të shumës së kontributit të padeklaruar;

dh) punëdhënësi, që ua mban kontributet punonjësve, por nuk i paguan ato në organet përkatëse, gjobitet me 50 për qind të shumës së kontributit të papaguar për çdo muaj;

e) punëdhënësi, që nuk mban regjistrimet në përputhje me pikën 1 të nenit 12, gjobitet me 30 000 (tridhjetë mijë) lekë.

Në çdo rast gjobat paguhen bashkë me kontributet dhe interesat përkatës.

Vendosja e gjobave dhe ankimimi i tyre bëhen në përputhje me ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.”.

Neni 6

Pas shkronjës “b” të nenit 13 shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“c) të gjitha shërbimeve të ekzaminimeve unike, terciare dhe konsultat mjekësore të miratuara nga Këshilli i Ministrave.”.

Neni 7

Në fund të nenit 14 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Tarifa e shërbimeve të parashikuara në nenin 4 pika 2 shkronja “c”, masa e mbulimit nga sigurimet shëndetësore dhe procedurat për mbulimin e shpenzimeve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 8

Neni 28 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 28

Mbledhja e kontributeve të sigurimeve shëndetësore i kalon si funksion Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në përputhje me fazat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Personat që kanë detyrimin për të paguar kontributet do të vazhdojnë të derdhin kontributet e sigurimeve shëndetësore bashkë me kontributet e sigurimeve shoqërore në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, deri në çastin që, me vendim të Këshillit të Ministrave, mbledhja e kontributeve do të bëhet nga organet tatimore.”.

Neni 9

Fjala e parë e pikës 1 të nenit 33 ndryshohet si më poshtë:

“Në buxhetin e ISKSH-së parashikohen të ardhurat, shpenzimet për barnat, për shërbimin nga mjeku i përgjithshëm ose i familjes, për të gjitha shërbimet e ekzaminimeve unike, terciare dhe konsultat mjekësore të miratuara nga Këshilli i Ministrave, si dhe shpenzimet administrative.”.

Neni 10

Pika 2 e nenit 35 ndryshohet si më poshtë:

“2. ISSH-ja nxjerr udhëzimet përkatëse për procedurat e regjistrimit dhe të pagesës së kontributeve për subjektet që do të vazhdojnë t'i derdhin kontributet në këtë institucion.”.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4192, datë 5.4.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

VENDIM

Nr.125, datë 18.3.2004

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE TELEVISIONIT (KKRT)

Në mbështetje të nenit 7 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të nenit 88 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet Raporti Vjetor i vitit 2003 për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT).

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Servet Pëllumbi**

VENDIM
Nr.126, datë 23.3.2004

**PËR SHKARKIMIN NGA DETYRA TË ANËTARIT DHE KRYETARIT TË KËSHILLIT
DREJTUES TË ENTIT RREGULLATOR TË TELEKOMUNIKACIONEVE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 86 shkronja “ç” të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 92 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Alqi Biraçi shkarkohet nga detyra e anëtarit dhe Kryetarit të Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

VENDIM
Nr.127, datë 23.3.2004

**PËR CAKTIMIN E KRYETARIT DHE ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË KËSHILLIT
DREJTUES TË ENTIT RREGULLATOR TË TELEKOMUNIKACIONEVE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 84 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 92 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Dule Dervishi caktohet në detyrën e Kryetarit të Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

II. Zonja Irena Malolli zgjidhet në detyrën e anëtarit të Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

VENDIM
Nr.128, datë 23.3.2004

**PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR EMËRIMIN E NJË GJYQTARI TË GJYKATËS
SË LARTË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 136 pika 1 të Kushtetutës dhe të nenit 92 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në dekretin e Presidentit të Republikës nr.4156, datë 2.3.2004,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Jepet pëlqimi për emërimin e zonjës Shpresa Beçaj në detyrën e anëtares së Gjykatës së Lartë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

VENDIM
Nr.179, datë 10.4.2004

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË MJEDISEVE TË DEGËS
SË MOBILIZIMIT NË QYTETIN E ÇOROVODËS, TË CILAT JANË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES DHE PËR NJË NDRYSHIM NË
VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME,
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI
MINISTRISË SË MBROJTJES”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “c” të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mjedisve të degës së mobilizimit në qytetin e Çorovodës t’i ndryshojë përgjegjësia e administrimit nga Ministria e Mbrojtjes te prefekti i qarkut të Beratit, për t’u përdorur për sistemimin e sektorit të PMNZSH-së.
2. Prona me numër rendor 1063 “Dega e mobilizimit”, Çorovodë, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.
3. Prefektit të qarkut të Beratit i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, prefekti i qarkut të Beratit dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.180, datë 10.4.2004

PËR DHËNIEN E EMRIT “SPIRO MOISIU” AKADEMISË SË MBROJTJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Akademisë së Mbrojtjes t’i jepet emri “Spiro Moisiu”.
 2. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.184, datë 10.4.2004

PËR MASËN E INDEKSIMIT TË PAGAVE PËR VITIN 2004

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 e 5 shkronja “h” të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar dhe të neneve 7 e 8 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Indeksimi i pagave për vitin 2004, të bëhet në masën 3,4 për qind.
 2. Indeksimi të bëhet sipas rregullave të miratuara në pikën 6 të vendimit nr.74, datë 12.2.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për indeksimin e pagave”.
 3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen sipas përcaktimit të bërë në pikën 7 të vendimit nr.74, datë 12.2.2004 të Këshillit të Ministrave.
 4. Pagat e punonjësve të sektorit të mbrojtjes dhe të rendit publik, të cilët paguhën me sistemin e pagës sipas gradës, përjashtohen nga indeksimi.
 5. Ngarkohen Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale, Ministri i Financave dhe Departamenti i Administratës Publike të nxjerrin udhëzimet përkatëse në zbatim të këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrinë efektet financiare nga data 1.4.2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

UDHËZIM
Nr. 2, datë 17. 2.2004

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.15, DATË 16.7.2003 "PËR PROCEDURAT E HAPJES DHE MBYLLJES SË SALLAVE TË LOJËRAVE ARITMETIKE, ELEKTRONIKE DHE PIKAVE TË LOJËRAVE TË FATIT SPORTIVE"

Në mbështetje të nenit 102/4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, ligjit nr.8701, datë 1.12.2000 "Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet" dhe në zbatim të nenit 1 pika 2 të vendimit nr.238, datë 13.4.2001 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret e dhënies së lejes për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet" Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Në pikën 1 germa "a" të udhëzimit nr.15, datë 16.7.2003 fjala "kërkesë" zëvendësohet me fjalën "njoftim".

2. Në pikën 2 germa "a" të udhëzimit nr.15, datë 16.7.2003 fjala "kërkesë" zëvendësohet me fjalën "njoftim".

3. Në pikën 3 germa "a" të udhëzimit nr.15, datë 16.7.2003 fjala "kërkesë" zëvendësohet me fjalën "njoftim".

4. Pika 5 e udhëzimit nr.15, datë 16.7.2003 ndryshon si më poshtë:

"Vetëm për shoqëri të licencuara në lojëra fati, për transferimin e automatëve të certifikuar dhe të miratuar, në rastet e shtimit ose heqjen e automatëve të rinj në sallat ekzistuese, detyrohen të njoftojnë Drejtorinë e Lojërave të Fatit, Kazinove dhe Hipodromeve pranë Ministrisë së Financave.".

5. Pika 6 e udhëzimit nr.15, datë 16.7.2003 ndryshon si më poshtë:

"Shoqëritë e lojërave të fatit detyrohen të njoftojnë me të njëjtën shkresë Drejtorinë e Lojërave të Fatit, Kazinove dhe Hipodromeve, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, degën e tatim-taksave të rrethit përkatës, 15 ditë përpara hapjes së sallave, pikave të basteve sportive, për transferimin, shtimin dhe heqjen e automatëve elektronikë.".

6. Pika 7 e udhëzimit nr.15, datë 16.7.2003 ndryshon si më poshtë:

Verifikimi i hapjes së sallave, pikave të basteve sportive, si dhe transferimi, shtimi ose heqja e automatëve elektronikë kryhet nga ana e Policisë Tatimore. Akti i verifikimit do të dërgohet në Drejtorinë e Lojërave të Fatit, Kazinove dhe Hipodromeve brenda 15 ditëve nga data e deklarimit të tyre.

"Në rast se shoqëritë e lojërave të fatit nuk paraqesin dokumentacionin e parashikuar në pikat 1, 2 dhe 3 të udhëzimit, nuk mund të ushtrojnë veprimtarinë pa e plotësuar këtë dokumentacion sipas kërkesave të këtij udhëzimi".

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin e tij në Fletoren Zyrtare.

MINISTËRI I FINANCAVE
Arben Malaj

UDHËZIM
Nr.3, datë 3.3.2004

PËR PROCEDURAT E TITULLIMIT TË PËRKOHSHËM TË AUDITËVE TË BRENDSHËM PUBLIKË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë të shkronjës "b" të nenit 13 të ligjit nr.9009, datë 13.2.2003 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.389, datë 12.6.2003 "Për përcaktimin e vjetërsisë në punë për

marrjen e titullit të përkohshëm “Audit i brendshëm në sektorin publik”, me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Auditimit të Brendshëm

UDHËZOJMË:

1. Do të konsiderohen si auditë të brendshëm publikë për një periudhë pesëvjeçare nga koha e hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.389, datë 12.6.2003 “Për përcaktimin e vjetërsisë në punë për marrjen e titullit të përkohshëm audit i brendshëm në sektorin publik” të gjithë ata specialistë që plotësojnë këto kushte:

a) Kanë mbaruar studimet e larta në njërën nga degët ekonomi, financë, kontabilitet, drejtësi ose, për raste të veçanta, në disiplina të tjera të përcaktuara rast pas rasti nga Drejtori i Përgjithshëm i Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave ose të kenë fituar titullin e ekspertit kontabël.

b) Në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr.9009, datë 13.2.2003 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” janë të punësuar në strukturat e kontrollit të brendshëm financiar ose të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe kanë një stazh pune jo më pak se katër vjet në këto struktura.

2. Në kuptim të këtij udhëzimi, do të konsiderohen stuktura të kontrollit të brendshëm financiar drejtoritë, sektorët, zyrat dhe specialistët e veçantë që kanë kryer funksione të kontroll-revizionit të brendshëm financiar në të gjitha subjektet e sektorit publik.

Nuk konsiderohen struktura të kontrollit të brendshëm financiar inspektoratet e të gjitha kategorive, në ministri dhe subjektet e tjera publike.

3. Dokumentacioni i kërkuar për t’u kualifikuar provizorisht si “Audit i brendshëm në sektorin publik” është si vijon:

- Kërkesa me shkrim drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Auditit të Brendshëm;
- Curriculum Vitae;
- Certifikatë personale;
- Fotokopje e diplomës dhe e certifikatës së notave (e noterizuar);
- Dëshmi penaliteti;
- Dëshmi e ekspertit kontabël të autorizuar, për ata që e kanë fituar këtë titull;
- Fotokopje e librezës së punës për vjetërsinë si revizor, e vërtetuar nga drejtori i burimeve njerëzore;
- Një vërtetim nga DAP-i se nuk është larguar nga shërbimi civil (nëse nuk e gëzon aktualisht statusin e nëpunësit civil);
- Vërtetim nga punëdhënësi aktual se nuk është larguar nga puna për shkelje të disiplinës nga punëdhënësit e mëparshëm dhe një vërtetim për vjetërsinë në punë si revizor, duke specifikuar qendrat e punës dhe periudhën e punuar.

4. Të gjithë auditët e brendshëm që kandidojnë për të fituar titullin e përkohshëm “audit i brendshëm në sektorin publik” duhet të paraqesin kërkesën e tyre me dokumentacionin përkatës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Auditimit të Brendshëm jo më vonë se 60 ditë nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi. Kërkesa dhe dokumentacioni i nevojshëm i paraqiten Drejtorisë së Përgjithshme nëpërmjet drejtorisë së auditimit në ministrinë e linjës, e cila jep opinionin paraprak në lidhje me përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në pikën 3 të këtij udhëzimi.

5. Pas verifikimeve të kryera, por jo më vonë se 15 ditë nga mbarimi i afatit të paraqitjes së dokumentacionit, Drejtori i Përgjithshëm i Auditimit të Brendshëm shpall listën përkatëse të kandidatëve që kualifikohen si të tillë.

6. Ankesat për shpalljen e listës i paraqiten Ministrit të Financave brenda 15 ditëve nga shpallja, vendimi i të cilit është përfundimtar.

7. Auditët e titulluar si më sipër pajisen me një certifikatë provizore, e cila nënshkruhet nga Ministri i Financave.

8. Certifikata regjistrohet në Regjistrin Kombëtar të Auditëve të Brendshëm, në seksionin e certifikatave të përkohshme dhe tërhiqet kundrejt nënshkrimit, identifikimit të personit (nr. i pasaportës) dhe një pagesë prej 2000 lekësh, e cila derdhet në arkën e Ministrisë së Financave.

9. Certifikata ka një afat prej pesë vjetësh dhe me kalimin e këtij afati ajo bëhet e pavlefshme. Çdo auditim i kryer me kalimin e këtij afati nga auditët e certifikuar si të përkohshëm konsiderohet i pavlefshëm.

10. Njësitë e auditimit në sektorin publik duhet të paraqesin për miratim në Drejtorinë e Përgjithshme të Auditimit të Brendshëm, nëpërmjet njërive të auditimit të brendshëm në ministrinë e linjës, kërkesat për specialitete jashtë atyre të përcaktuara në pikën 1/a dhe argumentet përkatëse për këto kërkesa, jo më vonë se 45 ditë nga dalja e këtij urdhri.

11. Brenda afatit prej pesë vjetësh nga hyrja në fuqi e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.389, datë 12.6.2003 “Për caktimin e vjetërsisë në punë për marrjen e titullit të përkohshëm “Audit i brendshëm në sektorin publik” auditët që kanë fituar titullin e përkohshëm duhet t’u nënshetrohen provimeve të kualifikimit dhe të kenë fituar titullin “Audit i brendshëm në sektorin publik”. Nëse brenda kësaj periudhe nuk arrihet të fitohet titulli përkatës, zbatohen kushtet e nenit 23 pika 2 e ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, kur janë nëpunës civilë ose largimi nga pozicioni i auditit të brendshëm, kur marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës ose ligje të tjera.

12. Njësitë e auditimit të brendshëm në ministrinë e linjës të marrin masa për të dërguar këtë udhëzim në të gjitha subjektet vartëse dhe Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore dhe prefekturat.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËRI I FINANCEVE
Arben Malaj

Stema

Për: Z. _____, specialist në Drejtorinë _____

Këtu:

Nga: _____ (Eprori i drejtpërdrejtë kur janë nëpunës civilë,
ose titullari i subjektit publik në raste të tjera)

Lënda: Për ndryshimin e kërkesave të vendit të punës

Në bazë të neni 13 të ligjit nr.9009, datë 13.2.2003 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.388, datë 12.6.2003 “Për ngritjen e komisionit shtetëror për kualifikimin e auditëve të brendshëm në sektorin publik” pika 16, si dhe urdhrit të Ministrisë të Financave nr._____, datë _____ “Për kualifikimin dhe certifikimin e auditëve të brendshëm publikë”, ju njoftojmë se kërkesat e vendit të punës për pozicionin tuaj aktual kanë ndryshuar.

Kërkesat e reja të vendit të punës kërkojnë detyrimisht certifikimin si “audit i brendshëm në sektorin publik” nga ana e komisionit shtetëror ose specialitetin financiar... etj.(në rastin kur specialiteti i të punësuarit nuk përputhet me kërkesat e nenit 13 të ligjit “Për auditimin e brendshëm”).

Nëse me kalimin e afatit prej gjashtë muajsh nuk arrini të certifikoheni si audit i brendshëm publik, (ose nuk keni fituar specialitetin e kërkuar financiar...etj) Ju njoftojmë se do të zbatohen kërkesat e nenit 23/2 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” (Ky paragraf është i vlefshëm vetëm për nëpunësit civilë).

(Për nëpunësit e tjerë vlen formulimi i mëposhtëm).

Nëse me kalimin e afatit prej gjashtë muajsh nuk arrini të certifikoheni si audit i brendshëm i sektorit publik (ose nuk keni fituar specialitetin e kërkuar financiar...etj.), në bazë të nenit 153 të Kodit të Punës dhe nenit 13 të ligjit nr.9009, datë 13.2.2003 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” (ose dispozita të tjera që rregullojnë marrëdhëniet e punës) ju ndërpriten marrëdhëniet e punës.

Eprori i drejtpërdrejtë
ose
titullari i subjektit publik

(Kur janë nëpunës civilë)

(Në rastet e tjera)

URDHËR
Nr.2591, datë 30.2.2004

PËR KUALIFIKIMIN DHE CERTIFIKIMIN E AUDITËVE TË BRENDSHËM PUBLIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë të shkronjës b” të nenit 13 të ligjit nr.9009, datë 13.2.2003 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.388, datë 12.6.2003 “Për ngritjen e komisionit shtetëror për kualifikimin e auditëve të brendshëm në sektorin publik”, me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Auditimit të Brendshëm,

URDHËROJ:

1. Brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij urdhëri, të gjithë punonjësit e strukturave të auditit të brendshëm në sektorin publik, të cilët në bazë të nenit 13 të ligjit nr.9009, datë 13.2.2003 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.389, datë 12.6.2003 “Për caktimin e vjetërsisë në punë për marrjen e titullit të përkohshëm audit i brendshëm në sektorin publik” kanë një vjetërsi pune më pak se katër vjet në strukturat e kontrollit të brendshëm, detyrohen t’u nënshtrohen provimeve të kualifikimit për t’u certifikuar si auditë të brendshëm të sektorit publik.

2. Komisioni shtetëror për kualifikimin e auditëve të brendshëm përbëhet nga:

- Beshir Ciceri	Kryetar
- Ylber Bezo	Anëtar
- Kolë Prenga	“
- Kryetari i Këshillit të Drejtimit të IEKA-s	“
- Bedri Lila	“
- Evelina Qirjako	“
- Drejtori i Përgjithshëm i Auditimit të Brendshëm	“

3. Brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e urdhrit, komisioni në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të Auditimit të Brendshëm të caktojë lëndët dhe programin për çdo lëndë, si dhe literaturën përkatëse mbi bazën e së cilës do të testohen auditët e brendshëm. Programi miratohet nga Ministri i Financave.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit, në bazë të nenit 13 të ligjit nr.9009, datë 13.2.2003 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe pikës 5 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.388, datë 12.6.2003 “Për ngritjen e komisionit shtetëror për kualifikimin e auditëve të brendshëm në sektorin publik”, brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, të shpallë në tre organe të shtypit me tirazh më të lartë kriteret dhe procedurat që duhet të plotësojnë kandidatët për t’u regjistruar për provimet e kualifikimit të auditëve.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit brenda 30 ditëve nga shpallja e kriterëve, të regjistrojë kandidatët, të bëjë seleksionimin e atyre që plotësojnë kriteret dhe t'i paraqesë komisionit listën zyrtare të kandidatëve që do t'i nënshtrohen provimit, e cila shpallet në ambientet e Ministrisë së Financave.

6. Ankimet për mospërfshirjen në listën e kandidatëve i paraqiten me shkrim Ministrit të Financave brenda 15 ditëve nga shpallja e listës, vendimi i të cilit është përfundimtar.

7. Përveç sa është parashikuar në pikën 1 të këtij urdhri, mund të regjistrohen për t'iu nënshtruar provimeve për të fituar titullin "Audit i brendshëm publik" edhe ato që e kanë fituar këtë titull përkohësisht ose profesionistë të tjerë që nuk janë të punësuar në këto struktura por plotësojnë kushtet për punësim sipas nenit 13 të ligjit nr.9009 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".

8. Komisioni të përcaktojë rregulloren e provimit dhe t'ia paraqesë atë për miratim Ministrit të Financave jo më vonë se 45 ditë nga hyrja në fuqi e këtij urdhri. Pas miratimit, rregullorja të shpërndahet dhe t'u bëhet e njohur të gjitha ministrive të linjës dhe nëpërmjet tyre të gjithë strukturave të auditit të brendshëm të sektorit publik.

9. Për çdo regjistrim fillestar, të punësuarit në strukturat e auditit të brendshëm publik paguajnë një tarifë prej 3000 lekë për çdo provim, kundrejt 5000 lekë për çdo provim që paguajnë kandidatët që nuk janë të punësuar në sektorin publik. Për çdo riprovim, tarifa e regjistrimit për çdo lëndë shtohet përkatësisht me 50 për qind.

10. Procesi i certifikimit të auditëve të brendshëm dhe kërkesat e dispozitave që e shoqërojnë atë konsiderohen ndryshim i kërkesave të vendit të punës në kuptim të nenit 24 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil". Prandaj të gjitha subjektet publike (eprorët e drejtpërdrejtë kur janë nëpunës civilë) duhet t'i komunikojnë me shkrim, sipas formës bashkëngjitur, të gjithë auditëve të punësuar kërkesat e këtyre dispozitave dhe t'i njoftojnë ata për pasojat që kanë, në rast se ato nuk mund të certifikohen sipas kërkesave të këtyre dispozitave. Njoftimi të shoqërohet edhe me ndryshime në përshkrimin e vendit të punës.

11. Njoftimi për ndryshimin e kërkesave të vendit të punës do t'iu dërgohet edhe atyre të punësuarve në strukturat e auditimit të brendshëm, pavarësisht nga vjetërsia në punë, në rastet kur specialiteti bazë i tyre nuk përputhet me kërkesat e nenit 13 të ligjit nr.9009, datë 13.2.2003 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".

12. Krijohet Regjistri Kombëtar i Auditëve të Brendshëm të sektorit publik sipas formës së përcaktuar nga Ministri i Financave. Regjistri depozitohet në zyrën e protokollit të Ministrisë së Financave dhe administrohet prej saj sipas rregullave për administrimin e dokumenteve zyrtare. Në këtë regjister regjistrohen në seksione të veçanta certifikatat e përkohshme dhe ato të përhershme.

13. Ky urdhër hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTËRI I FINANCEVE
Arben Malaj

VENDIM
Nr.7, datë 1.4.2004

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i	Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i	" "
Gjergj Sauli	Anëtar i	" "
Alfred Karamuço	Anëtar i	" "
Kristofor Peçi	Anëtar i	" "
Kujtim Puto	Anëtar i	" "
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	" "

Petrit Plloçi
Sokol Sadushi

Anëtar i “ “
Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 1.4.2004, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore mbi bazë dokumentesh çështjen nr.13 Akti që i përket:

KËRKUES: QEMAL GJOKUTAJ, PËLLUMB BALILAJ, SELAM TAKA, DILAVER BAJRAMAJ, FASLLI CERENISHTI DHE BEQO BEJKO

OBJEKTI: Ndreqje e gabimit material në vendimin nr.20, datë 2.7.2003 të Gjykatës Kushtetuese, si dhe ripërtëritjen e aktit.

Kërkuesit parashtrojnë në kërkesën e tyre ndreqjen e gabimit material në vendimin nr.20, datë 2.7.2003 të Gjykatës Kushtetuese, lidhur me numrin e vendimit 1952 dhe datën 19.12.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi dhe shqyrtoi çështjen mbi bazë dokumentesh,

VËREN:

Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.20, datë 2.7.2003, ka vendosur: “Shfuqizimin si antikushtetuese të vendimeve nr.1458, datë 20.4.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.1006, datë 24.9.2001 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.1952, datë 19.12.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë”.

Kërkuesit në datën 5.9.2003 i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese me një kërkesë me objekt rishikimin e vendimit nr.20, datë 2.7.2003. Kolegji i Gjykatës Kushtetuese me vendimin nr.172, datë 8.10.2003, ka vendosur moskalimin e çështjes në seancë plenare me arsyetimin se Gjykata Kushtetuese nuk mund të anulojë vendimin e saj. Në këtë kërkesë ata e kanë ngritur pretendim për numrin e vendimit nr.1952 dhe datë 19.12.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, por kjo nuk ka qenë objekt i kërkesës.

Pas vendimit të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese, kërkuesit në datë 23.10.2003, i janë drejtuar përsëri kësaj Gjykate dhe kërkojnë sqarime dhe interpretim të vendimit nr.20, datë 2.7.2003 të Gjykatës Kushtetuese. Me shkresën nr.7 Prot., datë 20.1.2004, Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese, i ka kthyer një përgjigje ku i sqaron kërkuesit se lidhur me kërkesën e paraqitur, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese është shprehur me vendimin e moskalimit nr.172, datë 8.10.2003.

Së fundi, kërkuesit në datë 19.3.2004 i janë drejtuar përsëri Gjykatës Kushtetuese me një kërkesë tjetër me objekt: “Ndreqje e gabimit material të vendimit nr.20, datë 2.7.2003 dhe ripërtëritje e aktit”. Motivi i kësaj kërkesë është se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në seancën e datës 16.2.2004, mbështetur në nenin 297/a të Kodit të Procedurës Civile, ka pezulluar gjykimin e çështjes deri në ndreqjen e gabimit material të konstatuar në vendimin nr.20, datë 2.7.2003 të Gjykatës Kushtetuese.

Nga shqyrtimi i çështjes, Gjykata Kushtetuese çmon se kërkesa e paraqitur është konform rregullave që parashikon ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” dhe pretendimi i tyre për ndreqjen e gabimit material në vendimin e saj është i drejtë dhe duhet pranuar.

Një gabim i aspektit material ekziston në vendimin e sipërcituar të Gjykatës Kushtetuese. Me këtë vendim, Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar tre vendime, nga të cilët vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë rezulton me numrin 1952, datë 19.12.2001. Në fakt, nga këqyrja e vendimit origjinal të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, rezulton se si numri i vendimit edhe viti janë shkruar gabim. Pra, numri 1252 i vendimit është shkruar 1952 dhe viti 2002 është shkruar 2001. Ky gabim material qëndron vetëm në këto shifra, ndërsa përsa i përket elementeve të tjera që lidhen me palët në gjykim, objektin e gjykimit si dhe arsyetimin e vendimit rezultojnë se janë identike.

Në këto kushte Gjykata Kushtetuese, duke u bazuar në neni 80 pika 1 shkronja “b” të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” dhe nisur nga fakti se pretendimi për ndreqjen e këtij gabimi material është paraqitur në afatin e caktuar, çmon se kërkesa është e drejtë e duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 23, 72 dhe 80 pika 1 shkronja “b” të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Ndreqjen e gabimit material në dispozitivin e vendimit nr.20, datë 2.7.2003 të Gjykatës Kushtetuese;
- Vendimi nr.1952, datë 19.12.2001 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë të korrigjohet si në shifrën 9 të numrit, ashtu edhe në vitin, duke u ndryshuar në vendimin nr.1252, datë 19.12.2002.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI NË JANAR 2004

1.	KUSHTETUTA	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

12.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
13.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000

BOTIME TË REJA

14.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
15.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600

Së shpejti në botim, përmbledhje në fushën e taksave dhe tatimeve

Doli nga shtypi më 16.4.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2004

Çmimi 150 lekë